



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin 12, paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr. 04/2017 mbi financimin publik të OJQ-ve, Zyra e Kryetarit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE TË PROJEKTEVE TË OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE)

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u bën thirrje për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive) të regjistruara dhe që marrin pjesë në gara zyrtare në federatat përkatëse.
2. Komuna e Kamenicës u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës (klubeve sportive), që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në Komunën e Kamenicës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e sportit në këtë komunë.
3. OJQ-të (klubet sportive), në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekte në fushën e sportit, sipas fushave mbështetëse si në vijim:
 - Mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të referimit për ndeshjet zyrtare, transportit për ndeshje zyrtare, ushqimit gjatë ndeshjeve, regjistrimit dhe kotizimit në federatat përkatëse, si dhe për blerjen e rekuizitave sportive.
 - Masivizimi i sporteve, promovimi i vullnetarizmit, organizimi i turneve të ndryshme sportive.

Dokumentet kryesore që kërkohen nga OJQ-të:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (obligative)
2. Certifikata e numrit fiskal (obligative)
3. Vërtetimi për përmbushjen e detyrimeve tatimore (dorëzohet para publikimit të rezultateve përfundimtare)
4. Projekt-propozimi i plotësuar sipas formatit të kërkuar (obligative)
5. Buxheti i projektit i plotësuar sipas formatit të kërkuar (obligative)
6. Deklaratë e nënshkruar që projekti nuk është financuar nga burime të tjera (obligative)
7. Deklaratë që OJQ-ja ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore
8. Deklaratë për përmbushjen e detyrimeve nga mbështetjet e mëhershme
9. Deklarata e partneritetit (nëse projekti realizohet në partneritet)
10. CV-ja e menaxherit të projektit
11. Dëshmi për implementimin e projekteve të ngjashme
12. Kopje e letërnjoftimit/pasaportës së përfaqësuesit të OJQ-së

13. Vërtetim i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopja e kartelës)
14. Vërtetim i regjistrimit të klubit/shoqatës në federatë
15. OJQ-të (klubet sportive) që kanë raport negativ nga komisioni i monitorimit nuk do të kualifikohen për mbështetje

Vlera totale financiare e thirrjes është **45,000 €**.

Shuma minimale për projekt është **500 €**, ndërsa maksimumi është **12,000 €**.

OJQ-të (klubet sportive) mund të aplikojnë vetëm me një projekt që kontribuon në avancimin e sportit në Komunën e Kamenicës.

4. Afati për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë pune**, duke filluar nga data **27.03.2026** dhe përfundon më **21.04.2026**.
5. OJQ-të mund të aplikojnë me vetëm një (1) projekt dhe vetëm në një nga fushat prioritare. Periudha e zbatimit të projektit është **6 muaj**.

Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të (klubet sportive) të regjistruara në Republikën e Kosovës, që veprojnë në Komunën e Kamenicës para datës së publikimit të thirrjes dhe që dëshmojnë se aktiviteti i tyre është në fushën e sportit.

Klubet sportive duhet të kenë realizuar transaksionet financiare në mënyrë transparente, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Kamenicës dhe ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare.

6. Para nënshkrimit të kontratës, klubi duhet të dëshmojë se personi përgjegjës dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale dhe se janë përmbushur të gjitha detyrimet tatimore.
7. Aplikimet dorëzohen vetëm në formularët zyrtarë, të cilët gjenden në:
<https://kk.rks-gov.net/kamenice>

Dokumentet dorëzohen personalisht në:

Komuna e Kamenicës

Rr. "Skënderbeu"

Zyra për Shërbim të Qytetarëve

Procesi përfshin:

- Vlerësimin e aplikacioneve
- Kontraktimin
- Dhënie të fondeve
- Procedurat e ankesave

Do të shqyrtohen vetëm aplikacionet e dorëzuara brenda afatit dhe që i plotësojnë kushtet.

8. Për informata shtesë:

Shehat Rrudhani

shehat.rrudhani@rks-gov.net

044/048/311/881

08:00 – 16:00

